

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "FERA STONE" SH.P.K"
SHKODER

**PERMBLEDHJE JOTEKNIK E
OBJEKTIT TE GURIT GELQEROR TE
MERMERIZUAR "VUKSANAJ", SHKODER**



Gjeografia e zones, relievi, klima, bimesia

Zona minerare Nr.216. ndodhet në jug të fshatit Vuksanaj, në bashkinë e Shkodres, rreth 30km larg nga qyteti i Shkodres.

Kjo sipërfaqe është një zone malore në afërsi të fshatrave Vuksanaj, në veri fshatrat Nikaj Shale dhe Lotaj në jug. Objekti ndodhet në të dy anët e rruges automobilistike Vuksanaj-Nikaj Shale në të dy anët e lumit të Shales.

Shtirja e kësaj sipërfaqe është veriperëndim-juglindje. Zona ndodhet në kufijte administrative të fshatrave Vuksanaj dhe Lotaj. Objekti ndahet në dy pjesë nga lumi i Shales, pjesë në afërsi të të cilit do të ruhen të paprekura deri në një distancë rreth 100m.

Terreni i zonës është kryesisht kodrinor-malor i aksidentuar nga agjentët atmosferikë. Objekti ka një shtirje gjatësore veriperëndim-juglindje. Tokat livadhe që ndodhen në perëndim dhe në veri të objektit janë shumë të pakta dhe përshkohen nga perroska të shumta pa rrjedhje uji gjatë stinës së verës.

Qendrat e banuar më të afërta janë fshati Vuksanaj dhe Lotaj që ndodhen perkatesisht i pari në lindje dhe jug lindje të zonës të zonës dhe i dyti po në jug të tij.

Zona është kryesisht e thatë në pjesën më të madhe të vitit. Përrenjtë me rrjedhje uji derdhen në lumin e Shales.

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së objektit është e çveshur nga bimësia e cila ndodhet në trajtën e shkurreve të ferrave, shkozës dhe dëllenjës lartësia e të cilave nuk i kalon 1.5 m.

Në afërsi të zonës gjenden disa livadhe të vogla të cilat përdoret për kullotjen e bagëtive të fshatit.

Klima

Klima është mesdhetare kontinentale me dimër të ashprë dhe verë të freskët. Ka reshje të shumta shiu dhe bore. Temperaturat mesatare luhaten nga +20° deri në +30° në verë dhe në dimër zbrasin nga -10° deri -20°. Temperatura mesatare vjetore luhetet rreth 20°.

Bimesia

Vendi ku kërkohet leja e shfrytëzimit pothuaj është i zhveshur nga bimësia. Sipërfaqja e objektit kërkohet për shfrytëzim që është gur gelqeror i mermerizuar si bimësi ka shkurret përfaqësohen nga frashi, shkoza, dëllinja, etj.

Relievi zones që kërkohet sipas kordinatave të percaktuara në plan

Rajoni ku përfshihet zona minerare Nr .216, ndodhet në të dy anët e lumit Shale dhe njëra karriere është në të majte të rruges automobilistike Shkoder-Shale. Kufijet e zone fillojnë nga horizonti +450m dhe vazhdojnë deri në lartësinë +640m.

Zona i përket ndarjes administrative të rrethit të Shkodres, qarkut të Shkoder.

Madhësia e sipërfaqes së kërkuar për shfrytëzim është 0.884km², kordinatat e së cilës janë si më poshtë:

Tabela me koordinatat e pikave

Pikat	Y	X
1	44 00 755	46 85 270
2	44 01 625	46 84 550
3	44 01 440	46 84 240
4	44 00 800	46 84 800
5	43 99 600	46 84 150
6	43 99 440	46 4 425

$$S_k=0.884\text{km}^2$$

Hidrografia dhe Hidrologjia.

Sic u permend me siper vendburimi gjeografikisht perfaqeson nje strukture monoklinale ne formen e nje shpati plotesisht te drenuar dhe nuk ka permbajtje ujrash ne te, me perjashtim te ndonje sasive te vogel ne kuotat e poshteme mbi kuoten e rruges qe vjen nga Vuksanaj dhe dhe shkon ne Shale dhe te proskave, qe ndodhen ne zonen e tij.

Nga pikpamja hidrogafike, lumi i Shales e ndan ne dy pjese objektin, objekti nuk ka brenda kufijve te tij perrenj te ndryshem ose vija ujendarese te cilat mund te ndikohen nga shfrytezimi i tij. Shfrytezimi rruan drejtimin e

pergjithshem te rrjedhes se ujrave te rreshjeve.

.Prania e ujrave te rreshjeve te shiut nuk veshtiresojne kushtet teknike te shfrytezimit te objektit pasi ato mund te rrjedhin ne drejtim te shpatit te kodres si dhe pergjate rruges qe do te ndertohet per lidhje ne objektit me ate e kzistuese .

Rreshjet e debore do te veshtiresojne kryesisht transportin e materialit te prodhuar ne karriere, I cili, per arsye te tyre, mund te nderpritet per intervale te kufizuar kohe .

Persa i perket kryerjes se proceseve teknologjike te shpimit te birave konturuese apo udhezuese, rrezimit, shkeptjes se materialit dhe blloqeve ne karriere zbankimit dhe ngarkimit te tyre , ndikimi i rreshjeve te debore do te jete relativisht i kufizuar me perjashtim te rasteve te temperaturave te ulta dhe ngricave.

Infrastruktura. Objekti i kerkuar lidhet me nje rrugen të kategorise se katert me rrugën automobilistike Shkoder-Nikaj Shalë.

Infrastruktura ekzistuese në zonë vlen për të dëshiruar dhe përbëhet vetëm nga një rrugë e ngushtë malore e shtruar me çakëll dhe e pa asfaltuar që lidh fshatrat e zonës.

Energjia elektrike merret nga hec Vuksanaj.

Lëvizja e popullsisë së zonës nga fshatrat në drejtim të qytetit dhe anasjelltas bëhet me autobuzë të vegjël të linjave dhe me furgonë.

Përsa i takon shërbimit shëndetësor në këtë zonë pothuajse nuk ekziston fare, ndërsa arsimi i Mesëm nuk ekziston, kurse ai 9-vjeçar ekziston i përqëndruar në fshatrat kryesore..

TE DHENAT MBI IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE HAPJES DHE SHFRYTEZIMIT TE OBJEKTIT

Llogaritja e garancise vjetore per rehabilitimin e mjedisit.

Eshte pasur ne konsiderate qe te shmanget demtimi i mjedisit ne dy anet e lumit Shala, prandaj zonat e shfrytezimit jane projektuar ne lartesi per te mos demtuar kanionin e lumit Shala dhe peisazhin ne rrugen qe shkon ne drejtim te Thethit.

Per llogaritjen e rehabilitimit te mjedisin jane marre siperfaqet qe preken nga ky shfrytezim dhe per karrieren, sheshin e depozitimit te sterilive dhe rrugen automobilistike te matura me metodat kompiuterike , autocad.

Siperfaqet jane me metoda kompiuterike, autocad dhe rezultojne si me poshte;

- Siperfaqja qe preket nga rruga eshte 3200 -218 (rruge qe perfshihet brenda karrieres = $2982 \text{ m} \times 5 \text{ m} = 14910 \text{ m}^2$
- Siperfaqja e stokut te sterilive eshte llogaritur parasysht sasine e sterileve qe do te dalin si skarcitete dhe sasine e sterive te zbulimit duke patur ne konsiderate pjerresine e shpatit ku ato depozitohen dhe rezulton se kjo siperfaqe eshte 12321 m^2
- Siperfaqja e karrieres lindore ku do punohet ne fazen e parer, sipas sqarimeve qe kemi dhene me siper deri ne shkallen +(570-580) eshte 30886 m^2

Siperfaqja totale qe preket nga shfrytezimi eshte 53747 m^2 ose 5.3747ha.

Mbeshtetur ne udhezimin nr.718 (Tabela ne vijim) vlera per nje ha eshte 322750 leke keshtu vlera totale per garancine e rehabilitimit te mjedisit do te jete $5.3747 \times 322750 = 1\ 734\ 844$ leke. Vlera vjetore e garancise per rehabilitimin e mjedisit do te jete:

$1\ 734\ 844 : 25$ vite jeta e minieres = 69387 lek/vit~ 69400 leke/vit